

VENDIM
Nr. 447, datë 27.5.2015

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR PËR
KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE
VENDORE TË VITIT 2015 DHE FINANCIMIN E PARTIVE PJESËMARRËSE NË
KËTO ZGJEDHJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 86, pika 2, e 87, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, t’i shtohet fondi prej 138 000 000 (njëqind e tridhjetë e tetë milionë) lekësh, fond i nevojshëm për organizimin e zgjedhjeve vendore të datës 21 qershor 2015.

2. Partive politike, në programin “Mbështetje për partitë politike”, t’u shtohet fondi prej prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh. Ky fond u shpërndahet partive politike, të regjistruara si subjekte zgjedhore, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zgjedhjet vendore të vitit 2015.

3. Efekti financiar prej 203 000 000 (dyqind e tre milionë) lekësh, i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama